



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE TË
SHOQËRISË KOMISIONERE DHE INSTITUCIONEVE TË TREGUT

Miraturar me Vendim Bordi nr. 92, datë 31.05.2023

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret, kushtet dhe procedurat për miratimin e shoqërisë së auditimit të shoqërive komisionere dhe institucioneve të tregut nga Autoriteti.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të nenit 112, pika 2 dhe nenit 131 të ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut të licencuara nga Autoriteti, të cilat ofrojnë një veprimtari të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.
2. Shoqëria komisionere me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, e cila ka themeluar një degë në Republikën e Shqipërisë, nuk është subjekt i kësaj rregulloreje. Pavarësisht kësaj, kjo shoqëri publikon në gjuhën shqipe, në faqen e internetit të degës, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura dhe të audituara në përputhje me rregullat e vendit të origjinës të shoqërisë mëmë, si edhe raportin vjetor, përfshirë raportin e audituesit, jo më

vonë se 5 ditë pas përfundimit të afatit për publikimin e tyre në vendin e origjinës së shoqërisë mëmë.

Neni 4 Përkufizimet

1. Termat e mëposhtëm në këtë rregullore do të kenë kuptimin e mëposhtëm:
 - a) “SNRF” nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
 - b) “Ligji” është Ligji nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”;
 - c) “Ligji për auditimin ligjor” është ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
 - d) “Shoqëri auditimi” është një person juridik, pavarësisht formës së organizimit, i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore dhe që plotëson kriteret e parashikuara në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
 - e) “Ortaku kryesor i auditimit” është:
 - i) audituesi ligjor i cili, në një angazhim auditimi, është ngarkuar nga shoqëria e auditimit me përgjegjësinë kryesore për kryerjen e auditimit ligjor në emër të shoqërisë së auditimit;
 - ii) në rastin e një auditimi të shoqërive të grupit, audituesi ligjor, i cili është ngarkuar nga shoqëria e auditimit me përgjegjësinë kryesore për kryerjen e auditimit të grupit;
 - iii) audituesi ligjor që nënshkruan raportin e audituesit ligjor të pavarur.
2. Të gjitha përkufizimet e tjera të kësaj rregulloreje kanë të njëjtin kuptim si ato në “Ligj”.

KREU II KRITERET PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË SË AUDITIMIT DHE PROCEDURA E MIRATIMIT NGA AUTORITETI

Neni 5 Kriteret për përzgjedhjen e shoqërisë audituese

1. Autoriteti miraton vetëm personin juridik që është i licencuar ose i regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë në Republikën e Shqipërisë si shoqëri auditimi, i cili përveç kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 112 të Ligjit, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit ligjor të subjekteve financiare që zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar(SNRF);
 - b) Të paktën dy nga ortakët ose personat e punësuar të kësaj shoqërie të kenë titullin profesional “Auditues ligjor”;
 - c) Gjatë dy viteve të fundit, të mos i jetë kërkuar, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ribërja e auditimit të kryer prej tij;
 - d) Të mos jetë subjekt i masave disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, për aq kohë sa kjo masë është në fuqi;
 - e) Të mos ketë konflikt interesi me shoqëritë komisionere /institucionet e tregut që auditon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe ligjeve të fushës.
2. “Ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “Auditues ligjor” duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme;
- a) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit ligjor të subjekteve financiare që zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar(SNRF);
 - b) Të kenë një etikë të lartë profesionale;
 - c) Të mos kenë konflikt interesi me shoqëritë komisionere/institucionet e tregut që auditojnë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe ligjeve të fushës.
3. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut duhet t’i lëshojë Autoritetit një vërtetim me shkrim se ortaku kryesor i auditimit i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 6

Dokumentacioni i kërkuar

1. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut duhet t’i paraqesë Autoritetit dokumentet e mëposhtme për miratimin e shoqërisë së auditimit:
 - a) Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë për emërimin e shoqërisë së auditimit apo emërimin e shoqërive audituese kur auditimi do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - b) Programin për auditimin e shoqërisë komisionere/institucionit të tregut;
 - c) Letrën e angazhimit të shoqërisë audituese për aktivitetin e shoqërisë komisionere/institucionit të tregut në Shqipëri, e cila përveç angazhimit për përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi, duhet të përfshijë edhe trajtimin e çështjeve që

lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për shoqëritë që janë subjekt i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”;

- d) Një dokument që vërteton se shoqëria e auditimit ose të paktën njëra prej shoqërive të auditimit, në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri auditimi, ka të paktën 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);
 - e) Një deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 5, pika 1, shkronja c) të kësaj rregulloreje;
 - f) Vërtetimi nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, që vërteton se ortaku kryesor i auditimit ose të punësuarit e shoqërisë audituese/shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët me titull “Auditues ligjorë” kanë jo më pak se 3 vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
 - g) Vërtetimin nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 5, pika 1, shkronja d), të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëritë audituese;
 - h) Deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 5, pika 1, shkronja e) dhe pika 2, shkronja c) të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - i) Dokumente apo informacione shtesë të kërkuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - j) Në rastin e auditimit të përbashkët nga 2 shoqëri audituese për dokumentat e parashikuara në shkronjat b) dhe c) të pikës 1, të këtij neni, duhet të depozitohen në një dokument të përbashkët. Për dokumentat e parashikuara në shkronjat g), h) dhe i), të pikës 1, të këtij neni, të dorëzohen për secilën nga shoqëritë audituese në rast auditimi të përbashkët.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar.
 3. Në rastin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, letra e angazhimit ose marrëveshja e auditimit duhet të dorëzohet origjinale ose kopje e noterizuar dhe duhet të shoqërohet me përkthim të certifikuar, në gjuhën shqipe.

Neni 7

Procedurat për miratimin e shoqërisë së auditimit

1. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut i paraqet Autoritetit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e plotë për miratimin e shoqërisë së auditimit, në përputhje me të gjitha kërkesat e Kreut II të kësaj rregulloreje jo më vonë se data 31 korrik të çdo viti kalendarik.

2. Autoriteti vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues të paraqitur në përputhje me kriteret e kësaj rregulloreje.
3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje ose është i paplotë, Autoriteti njofton për këtë shoqërinë komisionere/institucionin e tregut brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e dorëzimit të tij.
4. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut duhet të dorëzojë dokumentet e kërkuara brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit të Autoritetit, sipas pikës 3 të këtij neni.
5. Data e pranimit të kërkesës për miratim të shoqërisë së auditimit do të konsiderohet data në të cilën aplikanti ka plotësuar të gjitha kërkesat për dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje.
6. Autoriteti miraton ose refuzon shoqërinë e auditimit të propozuar nga shoqëria komisionere/institucioni i tregut brenda 2 (dy) muajsh nga data e paraqitjes me shkrim të aplikimit të plotë.

Neni 8 **Miratimi i shoqërisë së auditimit**

1. Autoriteti miraton si shoqëri auditimi të një shoqërie komisionere/institucioni tregu vetëm personin juridik të caktuar nga shoqëria komisionere/institucioni i tregut, i cili është i autorizuar për të kryer veprimtarinë e auditimit ligjor në Republikën e Shqipërisë dhe që është i regjistruar në “Regjistrin Publik të Audituesve ligjorë”, si dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin për auditimin ligjor dhe vepron në përputhje me kriteret e kësaj rregulloreje dhe procedurat e përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.
2. Nëse shoqëria komisionere/institucioni i tregut ndryshon shoqërinë e auditimit brenda vitit financiar të miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ajo merr miratimin paraprak të Autoritetit për shoqërinë e re të auditimit.

Për këtë qëllim, shoqëria komisionere/institucioni i tregut duhet të paraqesë pranë Autoritetit dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Një kërkesë për ndryshimin e shoqërisë së auditimit;
 - b) Shkaqet dhe arsyet e ndryshimit të shoqërisë audituese;
 - c) Dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
3. Për ndryshimin e shoqërisë së auditimit, Autoriteti zbaton të njëjtat procedura dhe kushte si ato të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Autoriteti miraton ose refuzon kërkesën e shoqërisë komisionere/institucionit të tregut për ndryshimin e shoqërisë së auditimit brenda vitit financiar.

Miratimi i Autoritetit jepet në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Nëse kërkesa për ndryshimin e shoqërisë së auditimit refuzohet, Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë komisionere/institucionin e tregut për arsyet e refuzimit.
5. Autoriteti refuzon miratimin e shoqërisë së auditimit nëse:
 - a. Nuk përmbushen kriteret dhe kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe të kësaj rregullore;
 - b. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, në rastet kur është kryer një kontroll i cilësisë së punës, në përfundim të kontrollit pasues, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën “C”.

KREU III FORMA E AUDITIMIT TË SHOQËRISË SË AUDITIMIT

Neni 9 Raporti dhe opinionin i shoqërisë audituese

1. Në bazë të kontrollit të raporteve dhe pasqyrave financiare për vitin ushtrimor, shoqëria audituese përgatit raportin dhe opinionin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me kërkesat në zbatim të kuadrit ligjor për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Raporti i shoqërisë audituese i dorëzohet drejtuesve të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut si dhe komitetit të kontrollit të brendshëm.

Neni 10 Procedura kontrolli

1. Shoqëria audituese bën vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin nga ana e shoqërisë audituese për:
 - a. Organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut;
 - b. Cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut për administrimin e aktiveve dhe pasiveve;
 - c. Organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave;
2. Shoqëria audituese i kërkon paraprakisht shoqërisë komisionere/institucionit të tregut gjetjet dhe rekomandimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për aspekte të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë komisionere/institucionit të tregut.
3. Shoqëria audituese përgatit një raport në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e saj mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë komisionere mbi cilësinë e rregulloreve të shoqërisë dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e shoqërisë.

4. Shoqëria audituese përgatit edhe një raport të audituar për procedurat e administrimit të rrezikut dhe zbatimin e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti. Raporti i audituar është pjesë e raportit vjetor të shoqërisë komisionere sipas përcaktimeve të nenit 109 të Ligjit.
5. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shpreh opinion mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të dorëzuara pranë Autoritetit.

Neni 11

Vlerësimi i raporteve të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut

1. Shoqëria e auditimit shqyrton shpeshhtësinë, përshtatshmërinë dhe plotësinë e raporteve të shoqërive komisionere/institucioneve të tregut të paraqitura pranë Autoritetit në përputhje me kriteret rregullatore në fuqi sipas ligjit dhe rregulloreve të miratuara për shoqëritë komisionere/institucionet e tregut.
2. Në bazë të auditimit të kryer në përputhje me pikën 1 të këtij neni, shoqëria e auditimit vlerëson nëse raportet e përgatitura janë në përputhje me kriteret e ligjit dhe/ose rregulloret që zbatohen për shoqëritë komisionere dhe nëse ato paraqesin një përshkrim real dhe objektiv të situatës financiare të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut.

Neni 12

Publikimi i raportit të auditimit

1. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut publikon raportin e auditimit të jashtëm, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga Asambleja e Aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.
2. Raporti i auditimit i publikuar përfshin opinionin e audituesit ligjor dhe pasqyrat financiare për të cilat është lëshuar opinionin, të hartuara në përputhje me kërkesat e zbatueshme të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, për shoqërinë komisionere/institucionin e tregut.

KREU IV

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 13

Marrëdhënia e Autoritetit me Shoqërinë e Auditimit

Autoriteti ka të drejtë të mbajë kontakte dhe të zhvillojë takime me shoqërinë e auditimit të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut sa herë që e gjykon të nevojshme.

Neni 14

Dispozitat e fundit

1. Shoqëria komisionere/institucioni i tregut depoziton në Autoritet “Ietrën për drejtimin” (Letra e menaxhimit), që shoqëria e auditimit harton për drejtuesit e lartë të shoqërisë komisionere/institucionit të tregut, si dhe një kopje të raporteve të shoqërisë audituese.
2. Shoqëria audituese e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kryhen kontrollin në të njëjtën shoqëri komisionere/institucion tregu më vete ose si pjesë e bashkimit të dy shoqërive audituese për një periudhë jo më të gjatë se katër vite në vazhdim, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy vitesh.
3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë t’i kërkojë shoqërisë audituese çdo informacion mbi veprimtarinë e saj. Shoqëria audituese është e çliruar nga sekreti profesional në dhenien e informacionit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund t’i kërkojë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, informacion mbi veprimtarinë e shoqërisë audituese. Informacioni i shkëmbyer do t’i nënshtrohet parimeve të konfidencialitetit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Hyrja në Fuqi

kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.